



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 27 prill 2017, në mbledhjen e XXXV (tridhjetepesë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11:15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Bahri Selimi, Radisav Perović dhe Xhafer Ademi, Mefail Rama, Shaban Osmani, Sabri Hamiti dhe Valmire Lahu, ndërsa mungoi Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Fadil Babatinca, Policia e Kosovës, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare dhe përfaqësuesi i KFOR-it.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, Ju falënderoj dhe ju shpreh mirëseardhje në takimin e sotëm. Rendin e ditës me materialet besoj i keni marrë me kohë. Nëse jeni dakord mund të fillojmë me punë.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22 mars 2017

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Analizë e realizimit të Planit të punës të Komitetit për Komunitete për tremujorin e parë të vitit 2017

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, fillimisht vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe bazuar në dispozitat ligjore është rritur numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete edhe me dy anëtarë të rinj. Sa i përket aktiviteteve, siç jeni në dijeni gjatë këtij tre mujori kemi bërë vizita familjeve në gjendje të rëndë sociale dhe të strehimit të komunitetit REA. Një prezantim i punës së komisionit gjatë realizimit të këtyre vizitave do të bëhet nga anëtarët e komisionit.

Fillimisht fjalën e ka z. Shaban Osmani.

z. Shaban Osmani, sa i përket Planit të punës në këtë tremujor ne komisioni në përbërje prej tre anëtarëve, i formuar nga ky Komitet, kemi realizuar disa vizita familjeve të komunitetit REA. Kemi vizituar familjen e Bashkim Behlulit prej 12 anëtarësh dhe kemi konstatuar se të njëjtit i është dëmtuar shtëpia nga zjarri. Kjo gjendje është evidentuar në formë të shkruar. Lidhur me këtë është njoftuar edhe

Kryetari i Komunës dhe brenda mundësive është ndihmuar. Gjendja e asaj familjeje është mjaft e rëndë, kulmi i shtëpisë i është djegur në tërësi, ndërsa ai me familje përkohësisht është duke banuar te një i afërm i tij.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, përveç punës dhe aktiviteteve të Komisionit Komiteti është marrë dhe ka shqyrtuar edhe çështje tjera, si atë të punësimit, arsimit, shëndetësisë etj. Gjithashtu vlen të theksohet sa janë miratuar disa kërkesa në lëmin e kulturës dhe sportit për nxënësit e komuniteteve ashkali rom dhe egjiptas, për këtë më hollësisht do ju informoj z. Xhafer Ademi.

z. Xhafer Ademi, unë kam paraqitur dy kërkesa në DKRS, njëra është që nxënësit e komunitetit ashkali, rom dhe egjiptas të shkojnë për vizitë nëpër Kosovë që të njihen me kulturën dhe monumentet historike, kjo kërkesë është miratuar. Kërkesa tjetër, komuniteti i ka disa të rinj që merren me sport – futboll dhe kanë dy skuadra ku marrin pjesë në të gjitha turnirët e futbollit që organizohen në Komunën e Podujevës dhe jashtë saj dhe kërkesa është bërë për mbështetje financiare për blerjen e rekuizitave të sportit për dy skuadrat e futbollit, gjithashtu kjo kërkesë është realizuar. Për këtë e falënderoj Drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

z. Liman Zeqiri, në tremujorin e punës dhe aktiviteteve të Komitetit është bërë punë dhe ka çka të flitet. Më datën 15.02.2017 duke falënderuar DKRS-në, komuniteti ashkali ka organizuar shënimin e Ditës së flamurit që ishte një festim i mirë, që isha prezent edhe vet, në atë aktivitet edhe Drejtoria ju ka përkrah dhe ndihmuar në atë aktivitet solemn dhe për 17 shkurtin Ditën e Pavarësisë. Sa i përket familjes së Bashkim Behlulit mendoj se ndoshta nuk kemi mundur ta ndihmojmë sa ka qenë e nevojshme ta ndihmojmë. Atij i është djegur shtëpia më dt. 31.01.2017, ka dymbëdhjetë anëtarë të familjes dhe normalisht ne kemi reaguar menjëherë si institucion dhe të gjitha organet kompetente përfshirë Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zjarrfikësit, Policia, të cilët i falënderojmë. Siç u theksua nga parafolësit si pasoj kulmi i shtëpisë i është djegur në tërësi, përfshirë orenditë shtëpiake dhe ka qenë me të vërtetë një humbje në kuptimin material. Kjo familje është ndihmuar me veshmbathje, mbulojë, gjëra ushqimore të cilat i quaj si ndihma emergjente, mirëpo kulmin edhe pse një kohë e gjatë nga djegia ende nuk kemi mundur t'i sigurojmë. Kam biseduar edhe me Kryetarin, por është çështje e buxhetit. Duhet prapë ta ngritim këtë çështje ngase ajo familje ka shumë nevojë për ndihmë, duhet bërë një zgjidhje. Kemi intervenuar edhe te Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që të angazhojë Kompaninë “ Pastrimi” që ti largoj një sasi të madhe të mbetjeve nga zjarri. Ai shërbim ju ka kryer dhe është falënderuar.

z. Xhafer Ademi, kur jemi te familja Behluli vlen të theksohet se jemi angazhuar bukur shumë, në fakt unë kam qenë më i angazhuari në emër të shoqatës. Nga Kryetari i Komunës kemi marrë premtime se kjo do të realizohet, gjithashtu edhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit na ka dhënë premtime, por ka shkuar një kohë bukur e gjatë. Ajo është familje e gjerë, gjendja e tyre është duke u rënduar më shumë pasi që dy familje janë grumbulluar në një shtëpi, dhe jetojnë në një kulm, ku jetojnë në kushte jo të mira dhe ka vend për frikë për përhapjen e ndonjë epidemie. Kisha për të lutur Kryetarin e Komunës por edhe Drejtorinë përkatëse që mundësisht në afatin sa më të shkurtër familjes se cekur ti sigurojnë kulmin e shtëpisë. Besoj se duhet të ketë mjete për raste emergjente dhe nuk besoj se ka ndonjë rast më emergjent se sa ky që jemi duke e shqyrtuar. Rast tjetër shumë shqetësues është edhe familja te hekurudha, kryefamiljari i të cilës ka vdekur. Kryefamiljarja nuk është e aftë për mbajtjen dhe përkujdesjen e atyre fëmijëve. Zgjidhje më e mirë për fëmijët është nëse ata merren dhe vihen në përkujdesje të institucionit publik përkatës. Fëmijët janë të sëmurë, s'kanë përkujdesje dhe fare kushte higjienike. Këtë familje e kemi vizituar me zyrtarin policor z. Fadil Babatinca dhe jemi marrë bukur shumë me të, andaj edhe këtu duhet diçka të ndërmerret.

z. Bahri Selimi, rasti i familjes që i është djegur kulmi është diskutuar gjatë në mbledhjet e Komitetit për Komunitete, mendoj se nuk ka qenë e nevojshme të bisedohet kaq gjatë dhe nuk mendoj se nuk ka

pas mundësi të ndihmohet, t'i bëhet një zgjidhje, mirëpo kjo nuk është varë prej neve si Komitet por është përgjegjësi e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS. Nuk duhet të merremi më me këtë çështje pasi që këtë e kemi deleguar me rekomandim që DSHMS ti bëjë zgjidhje. Atë që ne mund ta bëjmë është që edhe njëherë ti rekomandojmë Drejtorisë së cekur.

z. Shaban Osmani, shprehu pajtimin që edhe njëherë ti rekomandohet DSHMS, që kryefamiljarit në fjalë ti ndihmohet dhe nëse është e nevojshme është mirë edhe Ministrisë ti drejtohem.

z. Liman Zeqiri, Kryetari i ka dhënë një përkrahje të përmendurit por nuk ka një buxhet enkas për ndërtim apo ngjashëm, por çështja është referuar te Drejtoria përkatëse që të gjendet forma dhe mënyra por edhe mundësia buxhetore.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, nëse nuk keni diçka tjetër rreth kësaj teme kalojmë në pikën e radhës.

4. Caktimi i datës së vizitës komuniteteve pakicë në Komunën e Podujevës

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, sipas Planit të punëve dhe aktiviteteve të Komitetit për Komunitete, njëherë në vit vizitojmë komunitetin serb në fshatin Metergoc, pastaj Shkollat në Orllan dhe Batllavë. Data e realizimit të vizitës të caktohet nga anëtarët e Komitetit.

Konstatim:

Anëtarët e Komitetit për Komunitete njëzëri erdhën në përfundim që dita e vizitës të bëhet brenda periudhës 15 - 19 maj 2017. Për ditën e caktuar me kohë të informohen anëtarët e Komitetit.

5. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.45'.

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 01-060/04-0036632/17
Podujevë,
27 prill 2017**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**